

Makro

19.06.09

*U*



7132  
186 P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

*Sjds*  
*Kopje*  
*KM*  
*APP*  
*80*

V E N D I M

Nr. 669, datë 11.6.2009

P Ë R

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, PËR ASISTENCË  
TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME

  
LULZIM BASHA

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET**

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DHE**

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË BOSNJË DHE HERCEGOVINËS**

**LIDHUR ME**

**ASISTENCËN E NDËRSJELLË MBI ÇËSHTJET**

**DOGANORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjë dhe Hercegovinës, këtej e tutje referuar si "Palë Kontraktuese";

Duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të patolerueshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare dhe fiskale për vendet e tyre respektive;

Duke konsideruar rëndësinë e llogaritjes së saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera mbi importet ose eksportet e mallrave si dhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës së këtyre mallrave;

Duke njohur nevojën për kooperim ndërkombëtar në çështjet lidhur me administrimin dhe aplikimin e ligjeve Doganore;

Të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive nëpërmjet kooperimit ndërmjet Autoriteteve Doganore;

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e Këshillit të Kooperimit Doganor mbi Asistencën Reciproke Administrative, të 5 Dhjetorit 1953;

Ranë dakort për sa më poshtë vijon:

## NENI I

### Përcaktime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) "Legjislacion doganor" do të thotë ligjet dhe rregulloret që janë të detyruara për t'u zbatuar nga të dyja Administratat Doganore në lidhje me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e mallrave sipas Detyrimeve Doganore, taksave si dhe kontrolleve të tjera lidhur me lëvizjen e mallrave nëpër kufijtë shtetërorë;
- b) "Detyrimet doganore" do të thotë gjithë detyrimet, taksat, kuotat dhe pagesa të tjera të cilat parashikohen dhe mbledhen në territoret e Palëve Kontraktuese, në zbatim të legjislacionit doganor, por pa përfshirë kuotat dhe detyrimet të cilat kufizohen afërsisht në shumën e kostos së përafërt të shërbimeve të kryera;
- c) "Autoriteti Kërkues" do të thotë Autoriteti Doganor i cili bën një kërkesë për asistencë në përputhje me këtë Marrëveshje ose Autoriteti që mer asistencë të tillë;
- d) "Autoriteti i Kërkuar" do të thotë Autoriteti Doganor i cili merr një kërkesë për asistencë në përputhje me këtë Marrëveshje ose i cili jep një asistencë të tillë;

- e) "Kundravajtje" (shkelje) do të nënkuptojë cdo shkelje të legjislacionit doganor si dhe cdo lloj përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni;
- f) "Autoritet Doganor" do të thotë në Republikën e Shqipërisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë - Administrata e Taksave Indirekte.
- g) "Të dhëna personale" do të thotë gjithë informacioni lidhur me personat e identifikuar ose të identifikueshëm.

## **NENI 2**

### **Fushëveprimi i Marrëveshjes**

1. Palët Kontratuese, nëpërmjet Autoriteteve të tyre Doganore do të japin asistencë njëra-tjetrës sipas mënyrave dhe kushteve të përcaktuara në Nenin 1, pika f) të kësaj Marrëveshjeje, sipas mënyrave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshjeje në drejtim të zbatimit të rregullt të legjislacionit doganor dhe në veçanti për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të këtij legjislacioni.
2. E gjithë asistenca dhënë në përputhje me Marrëveshjen në fjalë, do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese të Kërkuar.

## **NENI 3**

### **Asistenca sipas Kërkesës**

1. Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar do ta furnizojë atë me informacionin përkatës në mënyrë që të mundësohet siguria se legjislacioni doganor është zbatuar korrektësisht, duke përfshirë inter alia, informacion lidhur me transportin dhe ngarkesën e mallrave, vendndodhjen dhe destinacionin e këtyre mallrave si dhe vlerën dhe origjinën, gjithashtu informacion lidhur me veprime të kryera ose planifikuara të cilat bien ndesh ose mund të bien ndesh me këtë legjislacion.
2. Mbi bazën e kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar do ta informojë atë nëse mallrat e eksportuara nga territori i tij prej Palës Kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duke specifikuar nëse është e nevojshme, procedurat doganore të aplikuar mbi këto mallra.
3. Sipas kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar do të ndërmarë hapat e nevojshëm për të siguruar se po mbahen nën survejim:

- a) persona të caktuar fizikë apo juridikë për të cilët ka baza të shëndosha mbi të cilat besohet se ata kanë shkelur apo janë duke shkelur legjislacionin doganor në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;
- b) vende ku janë magazinuar mallra në mënyre të tillë që të bën të dyshosh se ato janë parashikuar për t'u importuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;
- c) lëvizjen e mallrave të njoftuara nga Autoriteti Kërkues si të tilla që mund të dyshosh se do të sjellin shkelje të legjislacionit doganor në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;
- d) mjetet e transportit për të cilat ka baza të shëndosha për të besuar se ato kanë qenë, janë ose do të përdoren për shkelje të legjislacionit doganor në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese.

#### **NENI 4**

##### **Asistenca Spontane**

Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, sic përcaktohet në Nenin 1, pika f) e kësaj Marrëveshjeje, brenda kompetencave të tyre do të furnizojnë njëra-tjetrën me asistencë, nëse ato e konsiderojnë të nevojshme mbi zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, vecanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

-akte të cilat kanë përbërë, përbëjnë ose do të përbëjnë kundravajtje të këtij legjislacioni dhe të cilat mund tu interesojnë Palëve të tjera Kontraktuese;

-mjete të reja ose metoda të përfshira në kryerjen e kundravajtjeve të këtij legjislacioni;

-mallra të njohura që kanë qenë subjekt i shkeljeve thelbësore ndaj legjislacionit doganor në territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

-persona të vecantë të njohur ose të dyshuar se kanë kryer kundravajtje ndaj legjislacionit në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese;

-mjetet e transportit dhe kontenieret, për të cilat ekzistojnë njohuri ose dyshime se kanë qenë përdorur, përdoren ose mund të përdoren për kryerjen e shkeljeve ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

## NENI 5

### Asistenca Teknike

1. Asistenca, sic parashikohet në këtë Marrëveshje do të përfshijë inter alia informacion lidhur me:

- a) aksione antikontrabandë që mund të ndërmeren për parandalimin e shkeljeve;
- b) metoda të reja aplikuar për kryerjen e shkeljeve;
- c) observime dhe gjetje që rezultojnë nga zbatimi i suksesshëm i mjeteve dhe teknikave të reja të antikontrabandës; dhe
- d) teknika të reja dhe metoda të përmirësuara të përpunimit të ngarkesave dhe pasagjerëve.

2. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, do të kërkojnë gjithashtu kooperim, nëse kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin kombëtar lidhur me:

- a) inicimin, zhvillimin ose përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;
- b) themelimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit ndërmjet tyre në mënyrë që të mundësohet shkëmbimi i sigurtë dhe i shpejtë i informacionit;
- c) mundësimin e koordinimit efektiv ndërmjet tyre, duke përfshirë shkëmbimin e personelit, ekspertëve dhe vendosjen e punonjësve ndërlidhës;
- d) marjen në konsideratë dhe testimin e pajisjeve ose procedurave të reja;
- e) thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave të tyre respektive doganore; dhe
- f) çdo çështje tjetër të përgjithshme administrative që nga koha në kohë mund të kërkojë aksione të përbashkëta.

## NENI 6

### Dërgimet/Njoftimet

Mbi bazën e kërkesës së Autoritetit Kërkues, Autoriteti i Kërkuar në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar do të marrë gjithë masat e nevojshme në mënyrë që:

- të dërgojë gjithë dokumentet
- të njoftojë mbi gjithë vendimet

të cilat bien brenda fushës që mbulon kjo Marrëveshje lidhur me një të ardhur, rezident ose të vendosur në territorin e vet. Në këtë rast do të aplikohet paragrafi 3 i Nenit 7.

## NENI 7

### Forma dhe Thelbi i Kërkesës për Asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentet e nevojshme për ekzekutimin e një kërkesë të tillë duhet të bashkëshoqërojnë kërkesën. Kur për shkak të emergjencës së situatës mund të bëhet kërkesë gojore, kjo kërkesë në mënyrë imediate duhet të bashkëshoqërohet nga një kërkesë me shkrim.
2. Kërkesat në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:
  - a) Autoritetin kërkues që bën kërkesën;
  - b) masat që kërkohet të mirën;
  - c) objekti dhe shkaqet për kërkesë;
  - d) ligjet, rregullat dhe elementet e tjerë ligjorë të përfshirë;
  - e) treguesit sa më ekzakte dhe të zgjeruar të mundur mbi personat fizike dhe juridike të përfshirë, lidhur me çështjen;
  - f) një përmbledhje të fakteve lidhur me çështjen, përvec rasteve të parashikuara në Nenin 6; dhe
  - g) lidhjen mes asistencës së kërkuar dhe çështjes për të cilën bëhet fjalë.

3. Kërkesa duhet të dërgohet në një gjuhë zyrtare të Autoritetit të Kërkuar, në Anglisht ose në një gjuhë të pranueshme prej atij Autoriteti.
4. a) Asistenca do të kryhet nëpërmjet komunikimit direkt mes Autoriteteve Respektive Doganore.  
b) Në rastin kur Autoritetet Doganore të Palës Kontraktuese të Kërkuar nuk janë agjensia kompetente për të përmbushur kërkesën, ajo do ta transmetojë në mënyrë të saktë kërkesën tek organet kompetente të cilat do të veprojnë sipas kërkesës në përputhje me fuqitë e tyre sipas ligjit, ose do të këshillojnë Autoritetin Kërkues mbi procedurat që duhen ndjekur lidhur me një kërkesë të tillë.
5. Nëse kërkesa nuk i përmbush detyrimet formale, korrektimi ose kompletimi i saj mund të kërkohet, gjithashtu mund të bëhet kërkesë për marrjen e masave paraprake.

## **NENI 8**

### **Ekzekutimi i Kërkesës**

1. Autoriteti i Kërkuar do të marrë gjithë masat e nevojshme për të ekzekutuar kërkesën, dhe nëse është e nevojshme, do të përpiqet të kërkojë çfarëdolloj mase zyrtare ose ligjore të duhur për kompletimin e kërkesës.
2. Autoriteti Doganor i një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së Autoritetit Doganor të Palës tjetër Kontraktuese, do të bashkërendojë çfarëdolloj investigimi të nevojshëm, duke përfshirë marrjen në pyetje të ekspertëve ose dëshmitarëve ose të personave të dyshuar se kanë kryer një shkelje, dhe do të ndërmarë verifikime, inspektime dhe hetime për gjetje faktesh lidhur me ceshtjet e referuara në Marrëveshjen në fjalë.
3. Sipas kërkesës, Autoriteti i Kërkuar, në mundësitë e veta maksimale, do të lejoje nënpunësit e Autoritetit Kërkues të jenë prezent në territorin e Autoritetit të Kërkuar, ndërkohë që nënpunësit e vet janë duke kryer investigime mbi shkeljet që i interesojnë Autoritetit Kërkues.
4. Autoriteti Kërkues, nëse kërkon, do të këshillohet mbi kohën dhe vendin e aksioneve që do të ndërmeren në përgjigje të kërkesës së kryer, në mënyrë që aksionet të koordinohen.
5. Punonjës të Autoritetit Kërkues, të autorizuar për të investiguar shkeljet, mund të kërkojnë që Autoriteti i Kërkuar të bëjë ekzaminimin e rregjistrave, librave, dokumentave të tjera si dhe të dhënave të medias lidhur me çështjen dhe të



furnizohen me kopje të këtyre materialeve ose me çfarëdolloj informacioni lidhur me shkeljen.

## **NENI 9**

### **Forma me të cilën do të Komunikohet Informacioni**

1. Autoriteti i Kërkuar do të komunikojë rezultatet e kërkimeve Autoritetit Kërkues në formën e dokumentave, kopjeve të noterizuara të dokumentave, raporteve dhe të ngjashmeve me to, dhe kur është e nevojshme, gojarisht.
2. Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni mund të zëvendësohen nga informacion i kompjuterizuar, prodhuar në çfarëdolloj forme për të njëjtin qëllim, bashkëshoqëruar nga cdo informacion i nevojshëm për interpretimin dhe shfrytëzimin e këtij informacioni të kompjuterizuar.

## **NENI 10**

### **Përrjashtime nga Detyrimi për të Dhënë Asistencë**

1. Në rastet kur Pala Kontraktuese e Kërkuar është e mendimit se përgjigja ndaj një kërkesë mund të bie ndesh me sovranitetin, sigurinë, politikat publike ose interesa të tjera themelore kombëtare, ose mund të shkelë sekrete profesionale, komerciale apo industriale, asistencë mund të refuzohet ose mund të përmbushet vetëm në bazë të respektimit të disa kushteve ose kufizimeve. Asistencë gjithashtu mund të refuzohet nëse kërkesa përfshin rregulla (ligje) valutore ose tatimore të tjera nga ligjet mbi detyrimet doganore.
2. Kur Autoriteti Kërkues bën një kërkesë për Asistencë, i cili vetë nuk do të mund ta përmbushte nëse i kërkohej dicka e tillë, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga Autoriteti i Kërkuar vendimi nëse do t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.
3. Nëse asistencë pezullohet apo mohohet, Autoriteti Kërkues duhet të njoftohet pa vonesë lidhur me këtë vendim dhe mbi shkaqet që çuan aty.

## **NENI 11**

### **Detyrimet për të Ruajtur Konfidencialitetin**

1. Cdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme në përputhje me këtë Marrëveshje do të jetë i një natyre konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë të njëjtën mbrojtje të zgjeruar nën ligjet përkatëse

lidhur me një informacion, të njëjtë me atë të aplikuar në Palën Kontraktuese që e merr atë.

2. Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm nëse niveli i mbrojtjes personale parashikuar nga legjislacioni i Palës Kontraktuese është ekuivalent. Palët Kontraktuese do të sigurojnë të paktën një nivel mbrojtjeje bazuar në parimet e paraqitura në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

## **NENI 12**

### **Përdorimi i Informacionit**

1. Informacionet, dokumentet dhe komunikimet e tjera të marra në kursin e asistencës reciproke mund të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen në fjalë, duke përfshirë përdorimin në proceset gjyqësore dhe administrative.
2. Autoriteti Kërkues nuk do të përdorë evidencat ose informacionin e marrë nën këtë Marrëveshjeje për qëllime të tjera veç atyre të përcaktuara në kërkesë, përpara marrjes së konsensusit me shkrim nga pala dërguese.
3. Kur nën këtë Marrëveshjeje, janë shkëmbyer të dhëna Personale, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese duhet të sigurojnë se këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në kërkesë dhe në përputhje me kushtëzimet që mund të imponojë Pala Kontraktuese e kërkuar.
4. Dispozitat e Paragrafit 1 dhe 2 të këtij Neni nuk do të zbatohen për informacionet që kanë të bëjnë me shkelje lidhur me drogat narkotike dhe substancat psikotrope. Informacione të tilla mund t'u komunikohen Autoriteteve të Palës Kërkuese të cilat janë direkt të lidhura me luftën ndaj trafikut ilegal të drogës.

## **NENI 13**

### **Dosjet, Dokumentat dhe Dëshmitaret**

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës, do të japin dokumentacion lidhur me ngarkesat dhe transportin e mallrave duke treguar vlerën, origjinën, vendndodhjen dhe destinacionin e këtyre mallrave.
2. Originalët e dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet janë të pamjaftueshme. Në bazë kërkesë specifike, kopjet e këtyre dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera duhet të autentifikohen (noterizohen) saktësisht.

3. Origjinalet e dosjeve, dokumentave dhe materialeve të tjera që kanë qenë dërguar tek Autoriteti Kërkues duhet të kthehen me mundësinë me të parë. Të drejtat e Autoritetit të Kërkuar ose të palëve të treta lidhur me to do të mbeten të pangacmuara. Sipas kërkesës, origjinalet e nevojshme për procedime ose qëllime të ngjashme duhet të kthehen pa vonesë.
4. Sipas kërkesë të Autoritetit Doganor të Palës Kontraktuese, Autoriteti Doganor i Palës tjetër Kontraktuese do të autorizojë nëpunësit e vet, (sipas përzgjedhjes së saj) nëse këta nëpunës pranojnë një gjë të tillë, të paraqiten si dëshmitarë në procese penale ose administrative në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, dhe të prodhojnë dokumente, dosje dhe materiale të tjera, ose kopje të autentifikuara të tyre, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për proceset. Një kërkesë e tillë duhet të specifikojë kohën, vendin dhe tipin e procesit si dhe statusin nën të cilin ky nëpunës do të dëshmojë.

#### **NENI 14**

##### **Shpenzimet**

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve të dala gjatë vënies në zbatim të Marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me ekspertet, dëshmitarët dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.
2. Nëse kërkohen ose dalin shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme lidhur me ekzekutimin e kërkesës, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese do të konsultohen për përcaktimin e kushteve dhe termave nën të cilat do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mbi mënyrën e mbulimit të shpenzimeve.

#### **NENI 15**

##### **Zbatimi**

1. Vënia në zbatim e kësaj Marrëveshjeje do t'i ngarkohet:

- Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë nga njëra anë, dhe
- Administratës së Taksave Indirekte në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës nga ana tjetër.

Ato do të vendosin mbi gjithë masat praktike dhe rregullimet e nevojshme për aplikimin e Marrëveshjes, duke marrë në konsideratë rregullat në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

2. Shkëmbimi i Informacionit që do të vijë si pasojë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Administratës së Taksave Indirekte në Bosnjë dhe Hercegovinës.
3. Pas konsultimeve, Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese mund të shpërndajnë çfarëdolloj udhëzuesish administrative të nevojshëm për vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.
4. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese mund të rregullojnë që shërbimet e investigimit të secilës pale të jenë në komunikim direkt me njera-tjetrën.

## **NENI 16**

### **Detyrime sipas Konventave Ndërkombëtare**

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të paragjykojnë detyrimet e vëna nga Konventat Ndërkombëtare të pranuar përkatësisht nga Palët Kontraktuese

## **NENI 17**

### **Zbatimi Territorial**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territoret Doganore të të dyja Palëve Kontraktuese sic përcaktohet në Legjislacionin e tyre kombëtar.

## **NENI 18**

### **Hyrja në Fuqi dhe Përfundimi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë nga dita kur Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur gjithë kërkesat e brendshme respektive ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.
2. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese bien dakort të takohen në mënyrë që të rishikojnë këtë Marrëveshje ose për të diskutuar mbi çështje të tjera doganore të cilat mund të shfaqen gjatë marrëdhënieve mes tyre, sipas kërkesës të njërës prej Autoriteteve Doganore ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të


Marrëveshjes, nëqoftëse nuk njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se nje rishikim i tillë është i panevojshëm.

3. Palët Kontraktuese mundet që në cdo kohë të rishikojnë ose amendojnë këtë Marrëveshje me konsensus të përbashkët.
4. Kjo Marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë, n.q.s nuk përfundon nga njëra prej Palëve Kontraktuese me shkrim me ane të kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të përfundojë së zbatuari gjashtë muaj pas marjes së një njoftimi të tillë.

**DËSHMITARË PËR SA MË SIPËR**, përfaqësuesit e autorizuar sipas rregullave nga Qeveritë përkatëse nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

E nënshkruar në ~~Bratislavë~~ më 14.07.2009, në dy origjinale, secila në gjuhët Shqipe, Boshnjake, Serbe, Kroate dhe Angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit do të mbizotërojë teksti në Anglisht.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË BOSNJË DHE HERCEGOVINËS**



## **ANEKS**

### **PARIMET BAZË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE**

1. Të dhëna personale që i nënshtrohen përpunimit automatik do të jenë ato që:
  - a) merren dhe procedohen me ndershmëri dhe në mënyre ligjore;
  - b) ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk përdoren në ndonjë mënyre që nuk përputhet me këtë qëllim;
  - c) janë adekuate, me lidhje dhe jo ekstreme me qëllimet për të cilat janë ruajtur;
  - d) janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të rinovuara;
  - e) ruhen në formën që lejon identifikimin e të dhënave me kusht për jo më gjatë se sa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen ato të dhëna;
2. Të dhënat personale që lidhen me shëndetin apo jetën seksuale, mund të mos përpunohen në mënyre atomatike n.q.s ligjet e brëndshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta aplikohet edhe për të dhënat personale që i referohen dënimeve kriminale.
3. Duhet të merren masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave përkundrejt ndonjë shkatërrimi të paautorizuar apo humbje aksidentale, si dhe kundër futjes së paautorizuar tek ato, ndryshimit apo shpërndarjes të tyre.
4. Çdo person duhet të ketë mundësi të:
  - a) përcaktoje ekzistencën e një skedari të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;
  - b) të përftojë në intervale të arsyeshëm dhe pa vonesa të rëpruara apo shpenzime, konfirmimin nëse të dhënat personale që lidhen me të janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe se këto të dhëna i komunikohen atij në një formë të lexueshme;
  - c) të përftojë, sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla nqs ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brëndshëm dhe çenojnë parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Aneksi;

d) ti mundësohet mbështetje nëse një kërkesë për komunikim, ose komunikim sipas rastit, përshtatje, fshirje të dhënash sic parashikohet në nënparagrafët b dhe c të këtij paragrafi nuk është e zbatueshme;

5.1 Nuk lejohet përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi, me përjashtim të rasteve brenda kufijve të përcaktuara në këtë paragraf.

5.2 Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi lejohet vetëm atëherë kur një shmangie e tillë parashikohet me ligj të Palës Kontratuuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes të:

a) mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësisë publike, interesave monetare të shtetit ose dënimit e shkeljeve kriminale;

b) mbrojtjen e thelbit të të dhënave ose të drejtave dhe lirisë së të tjerëve.

5.3 Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, nënparagrafët b), c) dhe d) të këtij Aneksi mund të sigurohen me ligj në rastin e dosjeve të të dhënave personale të kompjuterizuara, të përdorura për qëllime statistikore apo për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për shkelje të privacisë së subjektit të të dhënave.

6. Asnjë nga dispozitat e këtij Aneksi nuk do të interpretohet si kufizim apo ndikim mbi mundësitë e një Pale Kontratuuese për ti dhënë subjektit të të dhënave një mase më të gjërë mbrojtjeje nga ajo që është përcaktuar në këtë Aneks.

NR.PROT.1912/1  
DATË 17.6.2009

PRESIDENCËS  
KUVENDIT  
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË INTEGRIMIT

